



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Npi-01/69 datë:12.02.2025

PROCESVERBAL

I takimit me qytetarë i mbajtur më datën 12.2.2025 në ora 11:h në sallën e Kuvendit, për diskutimin publik lidhur me shpalljen me Interes të përgjithshëm objektin Afaristo-Banesor para ndërtesës së Komunës si dhe oborrin e saj në ngastrën kadastrale Nr. P-01667-1, Z.K-Shtime, (Njoftimi publik Nr.2/44, i datës 29.01.2025). Në mbledhje kanë marrë pjesë 43 qytetarë, por në vazhdim numri është shtuar.

Temat:

- Njoftimi i qytetarëve me Projektin për rrënimin e objektit Afaristo-Banesor para ndërtesës së Komunës,
- Ndërtimin e një parkingu nëntokësor të automjeteve dhe një shesh mbi këtë sipërfaqe,
- Shpalljen me Interes të përgjithshëm objektin dhe oborrin e saj në ngastrën kadastrale Nr. P-01667-1, Z.K-Shtime,
- Kompensimi i pronarëve, të lokaleve afariste dhe banesore,

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Mbledhjen e hapi Kryetari, ku fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, më gëzon fakti që në këtë takim po merrni pjesë kaq shumë qytetarë, kjo tregon se jeni qytetarë aktiv të kësaj komune, por me siguri që edhe u lidhin interesa të ndryshme lidhur me realizimin e këtij projekti. Fillimisht dua që të ju njoftoj se jemi të lumtur që Qeveria e Republikës së Kosovës i ka nda dhe Kuvendi i ka buxhetuar rreth 3 milion euro për realizimin e këtij projekti.

Këtë objekt e ka ndërtuar para luftime një konzorcium publiko-privat i pushtetit të atëhershëm serb. Në këtë objekt ka pronarë të ndryshëm edhe afarist edhe banesor. Drejtorja e Urbanizmit i ka identifikuar të gjitha njësitë dhe i kemi fletat poseduese. Të gjithë pronarët e ligjshëm do të kompensohen. Siç e dini tani më kemi filluar me dislokimin e objektit të administratës komunale, dhe këtu po pretendojmë me bërë një shesh, dhe një parking nëntokësor për Automjete. Në bazë të Planit Zhvillimor, por edhe vizionit tonë për Shtimin këtu në këtë zonë do të mbetet qyteti i vjetër por i artë ashtu qysh ndodhë në shumicën e qyteteve të zhvilluara. Sa i përket Entit Special, tani më qysh edhe e kemi kuptuar do të dislokohej, dhe aty do të bëhet një park për qytetarët. Ne po punojmë për një Shtime urbane, dhe në këtë vision po na përkrah edhe niveli qëndror. Qyteteve fqinje sa here që shkojmë u marrim lakmi, mirëpo ne do të punojmë me përkushtim që banorët e komunës tone ta ndiejn veten të kënaqur këtu ku janë dhe ku jetojnë, kështu që ne do ti realizojmë këto projekte pa humbur kohë. Duke mos dashur që tua marr kohën kisha dashur me hapë debatin dhe me i dëgjuar edhe mendimet e juaja.

z.Azem Xhema-Lagja e Pajtim: Përshëndetje. Prezantimi i Kryetarit për këtë projekt mu duk shumë i mirë për ndërtimin këtu të një sheshi për qytetarë, dhe unë besoj se këtë mendim e ndajë edhe me shumicën e pjesëmarrësve këtu. Por unë kam disa pyetje, e para kur do të fillojë rrënimi i këtij objekti, dhe e dyta si do të kompensohen pronarët? Me na treguar pak më në detaje. Ne si pronarë i kemi ble këto njësi afaristo-banesore në atë kohë të tranzicionit pas luftës me qmime bukur te larta dhe e posedojmë edhe dokumentacionin për to, unë kam fletë poseduese sepse i kam kryer të gjitha, ndërsa dikush mund të ketë vetëm kontratën e shitblerjes. Shkurt ne kërkojmë shumën që e kemi paguar atëherë. Qysh është ndërtuar ky objekt në atë kohë ne nuk kemi asnjë ndikim dhe nuk është faji jonë. Sa e kemi kuptuar, ne do të paguhemi vetëm me para. Tjetër pyetje është çka dhe sa presim nga Kompensimi?

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Mekanizmat në Kosovë për sa i përket shpronësimit të pronave funksionojnë ashtu që kur një prone ose objekt shpallet nga Kuvendi me Interes të përgjithshëm, fillon pastaj procedura e shpronësimit. Në Ministrinë e Financave ekziston një Komision vlerësues të pronave të përfshira në shpronësim. Komisioni del në vendin e ngjarjes dhe e shikon dhe bën vlerësimin e pronës sipas kriterëve ligjore dhe vlerës së pronës mbi bazën e tregut. Komisioni e caktonë çmimin për secilën njësi dhe pastaj nëse pronari nuk është i kënaqur me vlerësimin mund ta apelojë në Gjykatë.

z.Azem Xhema-Lagja e Pajtimit: Kur do të fillojë puna, sepse duhet të ndërpriten aktivitetet e bizneseve në këtë objekt?

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Siç e thash buxheti për këtë projekt është i ndarë, tani neve na nevojitet që ti përfundojmë procedurat për shpalljen me interes të përgjithshëm dhe ne do të ngutemi që të kryejm shpronësimet por gjithnjë duke respektuar procedurat ligjore. Është me interes që të jenë në dijeni të gjitha bizneset që operojnë në këtë objekt se duhet të largohen nga aty. Por ne do të ju mbajmë të informuar me kohë për secilin veprim që do ta marrim.

z.Shefshet Imeri - Raçak: Përshëndetje. Ju dëgjova me vëmendje, për këtë projekt, unë nuk besoj që është dikush kundër. Meqenëse jemi në fillim të realizimit të kësaj projekti unë po dua me ditë, se a do të kemi edhe ndonjë takim tjetër lidhur me këtë rast? pra a do të jemi të njoftuar edhe ndonjëher tjetër se deri ku kanë arritur punët për shpronësimin e objektit dhe rrënimin e tij.

z.Nexhmedin Qerkini: Përshëndetje. U tha se vlerësimi do të bëhet dhe pronarët do të kompensohen, por a do të ketë buxhet për me na u pagu edhe fitimi ynë i humbur në këtë objekt, a hynë edhe ajo apo do të paguhen vetëm metrat katrorë të objektit?

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ: Përshëndetje. Lidhur me kompensimin e pronarëve këtu po flitet siç e tha edhe Kryetari për pagesën e pronarëve sipas çmimit të tregut të cilin do e përcaktojë Komisioni vlerësues kompetent nga Ministria e Financave. Pronarët e objektit do të kompensohen me para ku pastaj edhe do të kenë mundësinë për me ble dikund një banesë ose lokal tjetër. Si objekt ne i kemi identifikuar 34 njësi, ku tani për tani kemi edhe disa probleme me pronarët real. Ky objekt faktikisht është objekt pa pronarë, me kulmin e dëmtuar ku uji pikon gjithandej, dhe ka bërë dëme serioze në strukturën e objektit, dhe është rrezik nga shembja e tij kështu që është edhe rrezik për kalimtarët e rastit pranë tij. Pastaj duke qenë i tillë pa pronarë në këtë objekt janë bërë e po bëhen edhe dukuri negative. Kryesore është që çdo banorë i kësaj objekti do të kompensohet për çdo meter katror.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Komisioni vlerësues është institucion kredibil, dhe nuk kemi arsye për me pas dyshime në vlerësimin e tyre për pronat. Ne kemi me u kujdesur që secili që ka pronë aty me u kompensu mbi bazën reale të vlerësimit të Komisionit të Ministrisë së Financave.

Ky objekt po paraqet rrezik për banorët, qoftë nga shembja e tij kështu që është edhe rrezik nga shembja e tij sepse edhe pullazi është shkatërruar dhe po pikë shiu, por edhe sistemi i ujësjellësit është prishur dhe ka rrjedhje të ujit në koridoret e objektit i cili qëndron pa përkujdesje.

Unë besoj se pronarët kanë me përfutur mbi bazën e kompensimit që do të bëhet. Unë ju kërkoj pak mirëkuptim, sepse procedurat ligjore duhet respektuar, dhe tek e fundit ky projekt është në të mirën e gjithë qytetarëve, edhe këtë fakt duhet marrë parasysh.

z.Azem Xhema-Lagja e Pajtimit: Po e marr prap fjalën sepse dua të sqaroj se unë së bashku me babgjyshin e kësaj z.Idajet Rexhepit që po shkruan aty, z.Safet Azizi nga Davidovci, kemi investuar edhe në lokalet tona që i kemi afër njëri tjetrit, por edhe kemi investuar në rregullimin e kulmit dhe e kemi renovuar tërësisht, dhe në këtë pjesë së paku nuk pikon uji shiut. Unë kam pas aty në lokalim tim qiramarrës, dhe i kam të gjitha faturat. Kështu që unë e kam dhe kontratën e shitblerjes ku e kam paguar 980 euro kvadratin (metrin katror).

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ: Unë fola vetëm për çmimin e banesave që po na vine në drejtori, me kontrata të shitblerjes e jo për çmimin e lokaleve afariste. Çdo vendim që na vjen nga Gjykata ne do ta respektojmë dhe do ta zbatojmë.

z.Shefshet Imeri - Raçak: Unë kërkoja me u informu më heret për sa i përket qiramarrësve që i kemi për me ju tregu me kohë me liru objektin? Unë po shpresoj që ne nuk do të shkelemi me çmimin.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Ne mund të ju themi se planifikojmë që këtë vit objekti të rënohet, dhe ne do të ju mbajmë të informuar së paku një muaj më heret. Komisioni vlerësues i ka protokolet e tyre mbi vlerësimin e pronave. Është mirë që e keni dokumentacionin, dhe ruani ato për sa i përket vlerësimit nga ana e Komisionit.

z.Shefshet Imeri - Raçak: A është e mundur me i pa ata të Komisionit, dhe me i konsultuar? Dhe a do të ketë edhe ndonjë takim tjetër?

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Unë jam Kryetarë, edhe për çdo problem që e keni, gjithmonë e keni derën e hapur, dhe kamë me i mbrojtur interesat e juaja si qytetarë. Rrini të qetë se nuk do të dëmtoheni. Ligji funksionon si këtu si në Prishtinë njësoj, kështu që edhe vlerësimi edhe kompensimi do të kryhet dhe nuk do të dëmtoheni.

z.Haqif Qarri - Shtime: Përshëndetje. Edhe unë jamë pronarë i një lokali. I kuptuam procedurat. Unë lokalin e kam ble në vitin 2002 me 1200 euro metrin katror. Unë e kam një pyetje për Kryetarin se a mundesh me na e dhënë një çmim paraprak për meter katror? Sepse atëherë 1200 euro metrin që e kam paguar ka pas vlerë të madhe e sot jo.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Për këtë shpallje të realizimit të këtijë projekti është procedurë shtetërore, janë hapa ligjor që duhen ndërmarrë, dhe ne nuk mundemi me e ndryshuar këtë linjë të procedurës, prandaj edhe nuk ka mundësi me dhënë çmim paraprak nga ana jonë.

z.Afrim Shaqiri - Shtime: Përshëndetje. Unë e kamë një pyetje për Kryetarin, si pronarë i një dyqani të perdeve në qendër, se a e keni llogaritur për me e mbyllë sheshin ku ne kemi me qenë të detyruar për me i mbyllë lokalet tona, sepse unë kam qenë i dëmtuar edhe atëherë me ndërtimin e vendaljes për autobus para lokalit tim.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Ju lus që ti merrni informatat zyrtare, sepse ka edhe dezinformata nga disa njerëz të caktuar për ta penguar realizimin e projektit për interesat e tyre. Subjekti politik PDK-ja në Shtime të gjitha projektet po i ngatërron për mos me pas efikasitet për një grusht vota me i fitu. Për aty ku po bëni pyetje nuk do të jetë shesh por do të jetë Pedonale në shërbim të qytetarëve me një ambient të bukur ku edhe biznesi juaj do të ketë më shumë kuptim. Ne do ta konsultojmë publikun për secilin projekt, sepse nuk jemi ardhur këtu me pre koka.

z.Beqir Brahaj - Shtime: Përshëndetje. Unë kamë një pyetje për Kryetarin, që ka të bëjë me brengën tonë kryesore të kësaj zone e që është se çka do të ndodhë me fatin e rrugës kryesore duke filluar nga rruga "14 Dhjetori" e deri te shtatorja e "Adem Jasharit" ose siç njihet ndryshe të "Trekëndëshi". Ne po e kuptojmë që ky projekt është në të mirën e qytetarëve, sepse po krijohen hapsira publike më shumë, prandaj edhe u urojmë suksese në këtë projekt. Por ne si biznese në këtë zone kemi disa paqartësi në këtë që ju e thatë Pedonale.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Ne kemi me biseduar me ju. Siç e dini, ne tani më e kemi sheshin "Ahmet Shtimja" dhe ky këtu që po flasim do të bëhet një shesh, kështu që këto dy sheshe kanë me u lidhë me një pedonale të bukur për qytetarë, por do të jetë e mirë edhe për biznese.

z.Nexhmedin Qerkini: Unë e kame dhe një pyetje për Kryetarin, a ka me u bë shesh vetëm kjo hapsirë ku është ky objekt apo ka me u përfshi edhe hapsira ku është "Eliabi" ?


Kryetari, z.Qemajl Aliu: Unë mendoj se nuk do të ishte keq me e përfshi edhe hapsirën ku është "Eliabi", për këtë kam me u ulë e me bisedu në nivelin qendror për një mundësi të tillë, por ju e dini se kjo është mjaft shumë e kushtueshme, kështu që tani për tani ne po flasim vetëm për këtë hapsirë këtu që e kemi bërë publike të objektit para ndërtesës së Komunës.

z.Shefshet Imeri - Raçak: A ka mundësi që në një takim tjetër ta organizoni dhe të marrim më shumë informata?














Kryetari, z.Qemajl Aliu: Unë e thash edhe në fillim se zyra ime është e hapur për secalin prej jush, po ashtu edhe zyra ligjore, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.






Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryetari i Komunës me qytetarë e mbylli në ora 12:33h.

Procesmbajtësi
z.Idajet Rexhepi



Kryetari i Komunës
z.Qemajl Aliu

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
18	PERPAZEM AHMETI	PEC VAR	
19	Ismeralda Kamberi	PRONAR	
20	Hakmet Kallaku	PRONAR	
21	Alpejton Liriu	—	
22	ISAK ZESARI	PRONAR	
23	LIRIM XHELAJDI	PRONAR	
24	Remtim Ndziraj	PRONAR	
25	GERIM BRANA	PRONAR	
26	XHEVAT ZERR	PRONAR	
27	LULZIM MUSTAFA	PRONAR	
28	RASHIDA JERRA	PRONAR	
29	GOGAWI LIRIU	PRONAR	
30	Gronit Hecani	PRONAR	
31	AFRIM SHACIRI	PRONAR	
32	HAZMI ADJIAJ	BIZNIS	
33	Albion Shaban	K. Shtet	
34	SEVDAIL HISEMI	QYTETAR	
35	FLORIDE HISEVI	ZYRTARE K.K. SHETRE	
36	Besmir Kodja	Qytetar	
37	SHAFIRIM HUSENI	ZYRTARE K.K.	

37	Sami Jamni	zyrtarë #K/W	
38	Beardhyl Ruketi	Drejtues DASH	
40	GROSTARIS unum	Drejtues	
41	Olona Tyroni	K. SHITIME	
42	Anita Kurdi	K. selbime	
43	Tilget Drolapri	K. selbime	
44			
45			
46			
47			
48			
49			
50			
51			
52			
53			
54			
55			
56			
57			
58			

